



Njoftim Publik

Në Komunën e Prishtinës është dorëzuar kërkesa 05 Nr. 350/02-23293/26 dt. 12.02.2026 (sipas E-leja KKN-00865), në emër të aplikuesve: Xhemajl Krasniqi, Adem Bajrami, Naim Kadishani, Fatmire Lahi, Fatime Dushi, Kadri Gashi, Avdi Gashi, Igballe Gashi, dhe Nexhmije Vitija me investitor “Ndërtimtari- J”, SH.P.K., e përfaqësuar nga Mustafë Javori, me seli në Lazicë, Malishevë, përmes së cilës kërkohet të përcaktohen kritere të caktuara për ndërtim, përkatësisht për hartimin e dokumentacionit ndërtimor/projektit kryesor për ndërtimin e ndërtesës shumë banesore dhe afariste, me etazhitet të B+S+P+6, në kuadër të bllokut urban “B-13”, tërësia “B”, të Planit Rregullues “Mat 1” dhe Planit Zhvillimor Urban- PZHU-së në Prishtinë, gjegjësisht në kuadër të parcelave kadastrale nr. 566-7;566-23 dhe 565-8 ZK Matiqan.

Komentet lidhur me këtë propozim duhet të dorëzohen nga data 01.04.2026 deri më 15.04.2026, në e-mail adresën: urbanizmi@prishtine.rks-gov.net

Kushtet e propozuara të ndërtimit	
a. Destinimi aktual apo i propozuar i shfrytëzimit të tokës:	Ndërtesa shumë banesore dhe afariste B+S+P+6
b. Vija rregulluese	Sipas planit rregullues/Rruga publike/Rruga e planifikuar
c. Vija ndërtimore	Sipas Planit Rregullues “Mat 1”
d. Lartësia e lejuar në proporcion me distancën nga kufijtë e parcelës kadastrale përgjatë rrugës publike	0.4H ose së paku 3m’(anësore)
e. Lartësia e lejuar në proporcion me distancën nga kufijtë anësor dhe të pasmë të parcelës kadastrale	0.4H ose së paku 3m’(anësore)
f. Përqindja e sipërfaqes ndërtuese bruto në proporcion me sipërfaqen e parcelës kadastrale	ISHP=40 % (844.80m ² e lejuar 509.44m ² e propozuar
g. Përqindja e sipërfaqes së gjelbëruar në proporcion me sipërfaqen e parcelës kadastrale	ISHGJ=40 %, e kërkuar, 30%+10 e propozuar
h. Përqindja e sipërfaqes bruto ndërtuese në proporcion me sipërfaqen e parcelës kadastrale	ISPN=1.8
i. Përqindja e sipërfaqes së përdorshme nëntokësore në proporcion me sipërfaqen e parcelës kadastrale	ISHPN=60 %- 1267.20m ² e lejuar 772.98 e propozuar
j. Numri i hapësirave për vend parkime të automjeteve në kuadër të parcelës	43 VP të brendshme dhe të jashtme
k. E drejta e ndriçimit natyror për dritaret ekzistuese	/
l. Materialet në sipërfaqet e jashtme të ndërtesave të reja	/
m. A ka qasje të pakufizuar në rrugë publike dhe infrastrukturë publike? Po ☒ Jo ☐ Nuk aplikohet ☐	
n. shfrytëzimi i propozuar a do të gjenerojë ndotje të mjedisit apo zhurmë me të madhe se sa zona për rreth? Po ☐ Jo ☒ Nuk aplikohet ☐ Sqaro:	
o. A është ndonjë nga punët ndërtimore në Zona të Mbrojtura, Zona të veçanta, ose Zona të Veçanta të Mbrojtura? Po ☐ Jo ☒ Nuk aplikohet ☐ Sqaro:	

Në bazë të Udhëzimit Administrativ të MMPH Nr. 06/2017, dt. 23.05.2017 për caktimin e procedurave për përgatitjen dhe shqyrtimin e kërkesave për kushte ndërtimore, leje ndërtimore dhe leje rrërimi për kategorinë I dhe II të ndërtimeve, neni 13, paragrafët 2 dhe 3, brenda dy ditëve nga pranimi i komenteve, do të vendosen në ueb-faqen e Komunës, si dhe brenda 5 ditëve nga përfundimi i periudhës së komenteve, Komuna do të ofrojë përgjigje me shkrim dhe përgjigje në formë shprehëse do të publikohet në ueb-faqe të Komunës.

Në të gjitha komentet që përcillen në adresën elektronike, të shënuar më lartë, të përshkruhet edhe numri i kërkesës, i shënuar në paragrafin 1 të këtij njoftimi publik.

Zyrtari:

